



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 807/4 prot.

Tiranë më 23. 8 .2021

VENDIM

Nr. 41 , datë 23. 8 .2021

PËR KONTROLLUESIN “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), relacionit të hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, datë 19.08.2021 (në vijim, “Relacioni i Hetimit Administrativ”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi” dhe/ose “DPT”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 53, datë 29.04.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike.

Zyra e Komisionerit, bazuar në pikat 1.3 dhe 1.6 të Pjesës 1, si dhe Pjesën 2, të Relacionit të Hetimit Administrativ, si dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Hetimi administrativ pranë Kontrolluesit është realizuar bazuar vetëm në përgjigjet e paraqitura më sipër nga ky i fundit.

Përgjigjet e paraqitura nga Kontrolluesi janë të pamjaftueshme dhe rezultojnë – në pjesën më të madhe të tyre – replikime të përgjigjeve që Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “AKSHF”) i ka paraqitur Zyrës së Komisionerit, në kuadër të të njëjtit hetim administrativ. Këto përgjigje, gjithashtu, bazohen në

referenca konkrete të shkresave të përcjella nga AKSHI për Zyrën e Komisionerit, në kuadër të hetimit administrativ të ushtruar pranë këtij të fundit.

Cilësisht, qasja dhe përgjigjet e Kontrolluesit demonstrojnë mungesë të hapur bashkëpunimi, si dhe një mungesë të theksuar të njohurive lidhur me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, veçanërisht, detyrimeve që ky legjislacion parashikon për kontrollues që përpunojnë të dhëna personale në shkallë të gjerë, siç është DPT.

Kësisoj, kontrolluesi mohon shprehimisht rolin e tij si kontrollues në lidhje me të dhënat që ai përpunon.

Zyra e Komisionerit thekson se detyrat, kompetencat dhe funksionet e Kontrolluesit janë të parashikuara në një mori ligjesh dhe aktesh nënligjore, të cilat përcaktojnë pa ekuivok cilësinë e tij si kontrollues të dhënash.

Përgjigjet e DPT në lidhje me cilësinë e tij si kontrollues i të dhënave që përpunon, si dhe në lidhje me aksesin në të dhëna, rezultojnë, respektivisht, të pasakta dhe të paplota dhe, rrjedhimisht, pa rëndësi për procesin e hetimit administrativ lidhur me përfshirjen e mundshme të këtij institucioni në popullimin e bazës së të dhënave objekt hetimi (data_tirana_2021_Backup_Backup.accdb), në të cilën rezultojnë të përpunuara të dhënat personale të 91 061 (*nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e një*) subjekteve të të dhënave (në vijim, “*Baza e të Dhënave*”).

Në bazë nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Kontrollues*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj (pika 5).

Ndërsa, “*Përpunues*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit (pika 7).

Në dritën e këtyre përkufizimeve, cilësia e kontrolluesit bartet nga personi i cili përmbush kushtet kumulative si vijon:

- a. Përcakton (vetëm apo së bashku me të tjerë), qëllimet dhe mënyrat e përpunimit; dhe
- b. Përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (parimi i përgjegjësisë, i parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Në cilësinë e kontrolluesit, DPT rezulton se përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale duke përmbushur, kësisoj, kushtet e pikës “a” më sipër.

Rrjedhimisht, DPT është e detyruar të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (germa “b” më sipër).

Bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në cilësinë e kontrolluesit, DPT ka detyrimin të garantojë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të cilat ky kontrollues përpunon.

Edhe pse, bazuar në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” (në vijim, “VKM nr. 673”), AKSHI (në cilësinë e bashkëkontrolluesit) bart detyrimin për të garantuar sigurinë dhe pacenueshmërinë e sistemeve të infrastrukturave kritike të përdorura nga institucionet shtetërore, si në rastin e DPT, dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me aspektet e sigurisë së të dhënave nuk përjashtojnë nga përgjegjësia ligjore institucionet në fjalë, të cilat kanë detyrimin të demonstrojnë përgjegjshmëri, si dhe mbajnë përgjegjësi, për realizimin e proceseve përpunuese në përputhje me dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Institucionet e administratës shtetërore, si DPT, nuk mund të justifikojnë anomali të dhe cenimet eventuale në sigurinë e të dhënave, me faktin se për këtë qëllim është përgjegjës AKSHI, bazuar në dispozitat e VKM nr. 673.

Zyra e Komisionerit vlerëson se angazhimi i përpunuesve/bashkëkontrolluesve të tjerë (të përcaktuar me akt nënligjor) nuk çliron Kontrolluesin nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave që Kontrolluesi është i autorizuar (me ligj) të përpunojë dhe administrojë;

2. Kontrolluesi ka dëshmuar haptasi një qasje jobashkëpunuese me Zyrën e Komisionerit, e cila, shoqëruar me mosadresimin e kërkesave të parashtruara në pikat (ii), (iv) dhe (v) të planit të hetimit në kundërshtim me nenet 30, 32 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative, pamundëson përmbushjen nga ana e Zyrës së Komisionerit të qëllimit të hetimit, sipas planit të saj të hetimit.
3. Siç rezulton edhe nga hetimet e mëparshme administrative, konkretisht, në bazë të urdhrit nr. 172 prot., datë 16.11.2020 (i cili është pjesë e raportit që i është paraqitur Kuvendit, më datë 08.02.2021), si dhe nga konstatimet në pikat 1.3 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ, në lidhje me çështjen e sigurisë së të dhënave, Zyra e Komisionerit ka konstatuar, ndër të tjera, si vijon:
 - (i) DPT ka hartuar një seri aktesh rregullatore, ku përfshihen parashikime mbi ruajtjen e konfidencialitetit.

Megjithatë, nuk janë konstatuar norma specifike që rregullojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që zhvillon institucioni në përmbushjen e detyrave funksionale.

- (ii) DPT ka miratuar një rregullore për sigurinë e informacionit në DPT, në të cilën janë specifikuar rregullat e përgjithshme për sigurinë e informacionit dhe përgjegjësitë për veprimet që lidhen me sigurinë e informacionit në DPT.

Në bazë të kësaj rregulloreje janë hartuar dhe disa politika dhe procedura në funksion të sigurisë së informacionit.

Megjithatë, nuk janë konstatuar procese monitorimi të standardizuara dhe periodike sipas rregulloreve të hartuara për mbrojtjen e aseteve dhe informacionit, për ruajtjen e integritetin të të dhënave, për disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit.

- (iii) Sa parashtruar në pikat (i) dhe (ii) më sipër, bazuar në dispozitat e udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara na subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*"), kontrolluesit janë përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, qoftë kur përpunojnë të dhënat me kapacitetet e tyre teknike dhe njerëzore, qoftë kur për ruajtjen e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave angazhohen subjekte të tjera, rast në të cilin kontrolluesi është i detyruar të veprojë edhe në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 19*").

Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimi nr. 48”), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve, si dhe ankesave të paraqitura ndaj Kontrolluesit, në respektim të së drejtës të tij për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi nuk u paraqit në seancë, si dhe nuk paraqiti asnjë njoftim për këtë mosparaqitje.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germës “dh/1” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

dh/1) kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë;

Në bazë të pikës 2, të nenit 39, të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me mungesën e bashkëpunimit dhe mosreagimin e Kontrolluesit në garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 32 dhe 39 (pika 1, gërma “dh/1”) si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 32 të Ligjit;
2. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e Ligjit, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit sipas pikave 1.3 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ.

Për këtë arsye, Kontrolluesi duhet:

- (i) të ndërmarrë nisma për përmirësimin e njohurive ligjore dhe teknike për adresimin e kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, nëpërmjet trajnimit të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre;
- (ii) të ketë në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve që i ngarkon legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, në harmoni me legjislacionin sektorial, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave;

Për këtë arsye, përveç njohjes dhe adresimit të aspekteve materiale të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale (të tilla si, por pa u kufizuar, parimet, kriteret ligjore, si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave), Kontrolluesi duhet të zbatojë edhe detyrimet që lidhen me masat tekniko-organizative, të cilat synojnë të garantojnë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale;

- (iii) të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
- (iv) me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 në harmoni me nenet 27 dhe 28 të Ligjit, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale (përfshirë, por pa u kufizuar, sa parashtrohet në gerrat (i) deri (ix) të pikës 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ).

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të gerrës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

- (v) Për përmbushjen e rekomandimeve sipas gerrave (i), (ii) dhe (iv) më sipër, rezulton i domosdoshëm investimi në kapacitete të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe planifikimi i burimeve të nevojshme financiare;

3. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme respektimin e detyrimeve të tij sipas gerrës “a” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit, për të kërkuar mendim/opinion nga Zyra e Komisionerit për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat

personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga këta kontrollues, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë;

4. Përveç sa rekomandohet shprehimisht në pikat 2 dhe 3 më sipër, Kontrolluesi duhet të adresojë të gjitha rekomandimet e tjera, që i zbatohen specifikisht atij, sipas pikave 1.3 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ;
5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen brenda afateve ligjore detyrimet sipas pikës 1, si dhe në vazhdimësi detyrimet sipas pikave 2 deri 4, të këtij akti;
6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
7. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në pikat 2 deri 4 të këtij akti, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave;
8. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 23.8.2021.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

